



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 5, datë 14.01.2021

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. Znj. Irena Çunoti, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
2. Znj. Irena Çunoti do të ushtrojë përkohësisht detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë, nga data 16.01.2021 - 15.04.2021.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Znj. Irena Çunoti do të paguhet me pagën e pozicionit të prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë.
4. Të njoftohen për këtë vendim Znj. Irena Çunoti, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

